VENDIM
Nr. 473, datë 31.7.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE SHTESAVE TË TJERA MBI PAGË TË ZËVENDËSMINISTRIT, FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE, PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT, NËPUNËSVE CIVILË DHE NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të ndryshuar, të shkronjës "h", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në shkronjën "c", të pikës 1, të kreut I, emërtimi "Inspektorati Qendror" zëvendësohet me "Inspektorati i Përgjithshëm";

b) Në pikën 8/1, të kreut III, fjalët " ... në Inspektoratin Qendror ... " zëvendësohen me " ... në Inspektoratin e Përgjithshëm ... ";

c) Në lidhjen nr. 9/1:

i. fjalët " ... në Inspektoratin Qendror ... " zëvendësohen me " ... në Inspektoratin e Përgjithshëm ... ";

ii. fjalët " ... Drejtor i drejtorive të përmbajtjes." zëvendësohen me " ... Zëvendësinspektor i përgjithshëm. Drejtor i drejtorive të përmbajtjes.";

iii. fjalët " ... Specialist një njësitë e përmbajtjes." zëvendësohen me " ... Inspektor/specialist një njësitë e përmbajtjes.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2025, përballohen nga buxheti i miratuar për Inspektoratin e Përgjithshëm për këtë vit dhe fillojnë nga momenti i emërimit të nëpunësve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku